



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 5106 Prot.

Roskovec, më 24.09 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë 24 / 09 / 2025

PËR

**DHËNIEN ME QIRA TË AMBIENTEVE PËRKATËSE PËR T'U PËRDORUR SI
ZYRA ADMINISTRATIVE NGA SHOQËRIA RAJONAL UJËSJELLËS
KANALIZIME FIER SHA"**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, nenit 54 shkronja "e/1", të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM-së nr. 1210, datë 11.12.2009, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kuman, të Qarkut të Fier", Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kërkesës nr.7131 prot, datë 26.08.2025 të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sha, ju paraqesim,

Për diskutim dhe miratim :

1. Dhënie me qira të ambienteve përkatëse për t'u përdorur si zyra administrative nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sha,
2. Propozohet që të vendoset në funksion të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sha, për t'u përdorur si zyra administrative, Pasuria me nr. 99, Zona Kadastrale 2326, e cila është në pronësi të Bashkisë Roskovec, sipas inventarit të pronave të Bashkisë Roskovec.
3. Në rast të miratimit të këtij projekt-vendimi në Këshillin e Bashkisë, ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit që të vijojnë me procedurat e hartimit të Kontratës së qirasë.

Konceptoi: E.Kocaqi

S.Kuka

Miratoi: E.Hoxha

V.Zeqo

Konfirmoi: D.Hoxha

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3(tre)

KRYETAR
Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

5106/1
Nr. ___ Prot.

Roskovec, me 24.09.2025

Lënda: Relacion mbi projekt-vendimin për dhënien me qira të ambienteve përkatëse për t'u përdorur si zyra administrative nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SHA.

KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

Roskovec

Të nderuar këshilltarë ,

Bashkia Roskovec , në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin dhe shfrytëzimin e resurseve të saj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posaçërisht të kaluara në pronësi të saj, me qëllim dhënien në përdorim të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike,

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, nenit 54 shkronja "e/1", të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM-së nr. 1210, datë 11.12.2009, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kuman, të Qarkut të Fier", Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 801 dhe në vazhdim; Kërkesës Nr. 7131 prot, datë 26.08.2025 të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier ShA për mundësimin e ambienteve për tu përdorur nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier ShA si zyra administrative,

Kërkojmë miratimin për vendosjen në dispozicion të Pasurisë me nr. 99, Zona Kadastrale 2326, e cila ndodhet në pronësi të Bashkisë Roskovec dhe figuron në inventarin zyrtar të pasurive të saj, për përdorim nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A., me qëllim përdorimin e saj si zyra administrative.

Bashkëlidhur:

1- Kërkesa Nr. 7131 prot, datë 26.08.2025

2- Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr. 1210 datë 11.12.2009

3- Planvendosja e pasurisë nr.99 , zona kadastrale 2326.

Konceptoi: E.Kocaqi

S.Kuka

Miratoi: E.Hoxha

V.Zeqo

Konfirmoi: D.Hoxha

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3(tre)

KRYETAR
Majlinda Buqi